



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr. 162 Prot

Gramsh më 21.07.2024

THIRRJE PUBLIKE PËR KËSHILLIN VENDOR TË RINISË

Bashkia Gramsh shpall thirrjen publike për anëtarësimin në Këshillin Vendor të Rinisë Gramsh. Thirrja është e hapur për të gjithë të interesuarit që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë banorë të bashkisë Gramsh
- të jenë 15 deri 29 vjec;
- të jenë përfaqësues të një organizate rinore ose për të rinjtë;
- të mos jetë i dënuar;
- të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore për të rinjtë;
- të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit të Këshillit Vendor Rinor.

Kandidatët për Këshillin Vendor Rinor, përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë duhet të paraqesin interesin e tyre brenda afatit të përcaktuar, në adresën: pranë Bashkisë Gramsh, Sheshi "Kamber Dërmyshi" Bulevardi "10 Korriku", duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- kërkesë me shkrim ku të shprehë interesin dhe motivimin për aplikim;
- jetëshkrim;
- fotokopje të dokumentave që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
- vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;
- referenca nga të paktën 2 bashkëpunorë të mëparshëm;

Thirrja për kandidatët e Këshillit Vendor Rinor publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes bëhet nga grupi i punës, i ngritur pranë Bashkisë Gramsh, duke u bazuar në kriteret dhe procedurat që parashikon ligji. Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve.

Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

Të përzgjedhurit njoftohen dhe bëhet prezantimi me Këshillin Vendor Rinor Gramsh.

KRYETARI
Besion AJAZI